

BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Tremujori I – 2026

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, energjia në dispozicion u rrit me 8,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.


Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike në këtë periudhë u rrit me 63,2 %, duke arritur në 3.647 GWh, nga 2.234 GWh në tremujorin e parë të vitit 2025.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 45,7 %, nga hidrocentralet private dhe koncesionare në masën 47,3 %, si dhe nga prodhues të tjerë në masën 7,0 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike, përfshirë shkëmbimet (energji në marrje), në tremujorin e parë të vitit 2026, arriti në 327 GWh, nga 767 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një ulje prej 57,4 %.

Eksporti bruto i energjisë elektrike, përfshirë shkëmbimet (energji në dhënie), në tremujorin e parë të vitit 2026, arriti në 1.503 GWh, nga 732 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 105,4 % (fig.1).

FIG. 1 ENERGJI NË DISPOZICION, PRODHIMI NETO VENDAS, IMPORTI DHE EKSPORTI BRUTO



TAB. 1 BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Treguesit		MWh	
		Tr. I 2025	Tr. I 2026
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	2.269.259	2.470.192
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	2.233.905	3.646.805
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	2.057.523	3.392.739
a	Publike (a=a.1-a.2)	1.022.784	1.666.663
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	1.032.261	1.679.355
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	9.477	12.693
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	1.034.740	1.726.076
1.3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	176.381	254.066
2	Importi bruto (energji në marrje)	767.187	326.815
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	731.833	1.503.429
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	2.269.259	2.470.192
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	477.816	515.817
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	51.088	67.361
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	426.728	448.456
a	Humbjet teknike në shpërndarje	312.071	336.635
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	114.657	111.821
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.791.443	1.954.375
2.1	Familjarë	1.064.956	1.158.522
2.2	Jo Familjarë	726.487	795.853

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike

² Humbjet jo teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në tremujorin e parë të vitit 2026, prodhuan 1.667 GWh, nga 1.023 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje të prodhimit me 63,0 %.

Hidrocentralet private dhe koncesionare prodhuan 1.726 GWh, nga 1.035 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje të prodhimit me 66,8 %.

Të tjerë prodhues prodhuan 254 GWh, nga 176 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje të prodhimit me 44,0 %.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në tremujorin e parë të vitit 2026, rezultoi pozitiv në nivelin 1.177 GWh, duke reflektuar një nivel më të lartë të eksporteve krahasuar me importet (fig.2).

FIG. 2 SHKËMBIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE




Humbjet në rrjet u rritën me 8,0 %, duke arritur në 516 GWh në tremujorin e parë të vitit 2026, krahasuar me 478 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Pesha e **humbjeve në rrjet** ndaj energjisë elektrike në dispozicion, gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, është 20,9 %, kundrejt 21,1 % në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një ulje prej 0,2 pikë përqindje.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, **humbjet në transmetim** u rritën me 31,9 %, ndërsa humbjet në shpërndarje u rritën me 5,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (fig.3).


FIG. 3 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE, HUMBJET NË RRJET DHE PËRDORIMI NGA KONSUMATORËT



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e parë të vitit 2026, u rrit me 9,1 %, duke arritur vlerën 1.954 GWh nga 1.791 GWh që ishte në tremujorin e parë të vitit 2025.

Në rritjen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët kanë ndikuar si **konsumatorët familjarë**, të cilët shënuan një rritje të konsumit me 8,8 %, ashtu edhe **konsumatorët jo familjarë**, të cilët shënuan një rritje me 9,5 %, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025 (fig.4).

FIG. 4 PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KONSUMATORËT



Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Energjia](https://www.instat.gov.al/Energjia)

Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë.

Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudha tremujore, bazuar në të dhëna mujore të grumbulluara nga burime administrative si:

- KESH sh.a., shoqëri shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a., shoqëri shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, si edhe ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes;
- OST sh.a., shoqëri shtetërore që operon sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet vendase;
 - tranzitin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energjia në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar në vend, së cilës i shtohet sasia e importuar (përfshirë shkëmbimet) dhe i zbritet sasia e eksportuar (përfshirë shkëmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shuma e prodhimit bruto të energjisë elektrike nga të gjithë prodhuesit në vend (hidrocentrale, termocentrale dhe prodhues të tjerë), duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energjia termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energjia hidro i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohen energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacioneve të prodhimit, si ftohja e ujit, shërbimet e brendshme, ndriçimi, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë i referohen prodhuesve privatë të energjisë elektrike, të cilët në Shqipëri përfshijnë impiante të privatizuara ose të ndërtuara nga subjekte private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit, licencohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin energji OST-së, OSSH-së apo klientëve të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo (p.sh. fotovoltajk).

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe tranzitet dhe shkëmbimet me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit të energjisë nga konsumatorët familjarë dhe jo familjarë, si edhe humbjeve në rrjet.

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në transmetim (duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim) dhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje vlerësohen nga OSSH sh.a., ndërsa humbjet jo teknike përfaqësojnë diferencën midis humbjeve totale në shpërndarje dhe humbjeve teknike, si edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mos përputhjet në kohën e matjes së prodhimit dhe konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorët familjarë dhe jo familjarë.

Konsumatorët familjarë i referohen konsumit të energjisë elektrike në familje.

Konsumatorët jo familjarë i referohen konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, bujqësisë, shërbimeve publike, etj, duke përjashtuar familjarët.